WATERBURY
PUBLIC SCHOOLS

Departmenti i Shërbimit të Ushqimit

Viti shkollor 2026-2027

Mëngjes dhe Drekë Falas për të Gjithë Nxënësit

12 gusht 2026

Të dashur Prindër ose Kujdestarë:

Kemi kënaqësinë t'ju informojmë se Shkollat Publike në Waterbury do të zbatojnë një program që është vënë në dispozicion për shkollat të cilat marrin pjesë në Programin Kombëtar të Drekës dhe Mëngjesit në Shkollë të quajtur **Community Eligibility Provision (CEP).**

Çfarë do të thotë kjo për ju dhe fëmijët tuaj që ndjekin Shkollat Publike në Waterbury?

Një lajm i shkëlqyeshëm! Të gjithë nxënësit e regjistruar në Shkollat Publike në Waterbury kanë të drejtë të marrin mëngjes dhe drekë të shëndetshme në shkollë **pa asnjë kosto** për familjen tuaj në çdo ditë të vitit shkollor. Fëmijët tuaj do të jenë në gjendje të marrin pjesë në këto programe ushqimi pa pasur nevojë të paguajnë një tarifë ose të dorëzojnë një aplikim për ushqimin.

Nëse keni ndonjë pyetje në lidhje me këtë letër, ju lutemi kontaktoni Adam Shaban në 203-574-8036.

Me respekt,

Adam Shaban
Drejtor i Shërbimit te Ushqimit

Në përputhje me ligjin federal për të drejtat civile, rregulloret dhe politikat e të drejtave civile të Departamentit të Agrikultures të SHBA-së (USDA), këtij institucioni i ndalohet të diskriminojë në bazë të racës, ngjyrës, origjinës kombëtare, seksit (duke përfshirë identitetin gjinor dhe orientimin seksual), aftësisë së kufizuar, moshës, ose masa ndëshkimore ose hakmarrje për një aktivitet të mëparshëm që lidhet me të drejtat civile.

Informacioni i programit mund të vihet në dispozicion në gjuhë të tjera përveç anglishtes. Personat me aftësi të kufizuara që kërkojnë mjete alternative komunikimi për të marrë informacion mbi programin (p.sh., Braille, shkronja të mëdha, kasetë audio, Gjuha Amerikane me Shenja), duhet të kontaktojnë agjencinë shtetërore ose lokale përgjegjëse që administron programin ose qëndrën USDA's TARGET Center në (202) 720-2600 (zanor dhe TTY) ose të kontaktojnë USDA-në përmes shërbimit Federal Relay Service në (800) 877-8339.

Për të paraqitur një ankesë për diskriminim në program, një Ankimues duhet të plotësojë Formularin AD-3027, Formularin e Ankesës për Diskriminim në Program të USDA-së, i cili mund të merret në internet në: https://www.usda.gov/sites/default/files/documents/ad-3027.pdf, gjithashtu në çdo zyrë të USDA-së, duke telefonuar në (866) 632-9992, ose duke shkruar një letër drejtuar USDA-së. Letra duhet të përmbajë emrin, adresën, numrin e telefonit të ankimuesit dhe një përshkrim me shkrim të veprimit të supozuar diskriminues me detaje të mjaftueshme për të informuar Ndihmës Sekretarin e të Drejtave Civile (ASCR) rreth natyrës dhe datës së shkeljejes të supozuar për të drejtat civile. Formulari ose letra e plotësuar AD-3027 duhet të dorëzohet në USDA me:

1. Postë: U.S. Department of Agriculture
   Office of the Assistant Secretary for Civil Rights
   1400 Independence Avenue, SW
   Washington, D.C. 20250-9410; ose
2. Fax: (833) 256-1665 or (202) 690-7442; ose
3. Email: program.intake@usda.gov

Ky institucion ofron mundësi të barabarta.